



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK-SHTATOR 2023**

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e prgj.	Përgjigje	Mënyra e përfundim it të kërkesës	Tarifa
05	10.07.2023	<p>1.A ka patur bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë(grupmoshën 15-29 vjeç)për periudhën janar-dhjetor 2022?</p> <p>2.A ka te punesuar prane Bashkise suaj individe te moshes 18-29 vjec (perfshire drejtuesit)? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?</p> <p>3. Sa eshte perqindja e te rinjve (18-29 vjec) te punesuar krahasuar me numrin total te administrates?</p> <p>4. A ka bashkia juaj politika rinore të zhvilluara specifikiisht për grupmoshën 15-29 vjeç?</p> <p>5. A keni ne institucionin tuaj struktura pergjegjese per politikat rinore?</p> <p>6. A ka struktura rinore te ngritura ne Bashkine tuaj dedikuar grupmoshes se te rinjve 15-29 vjec (qendra/zyra rinore, keshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) per periudhen janar - dhjetor 2022.</p> <p>7. Me ke keni bashkepunuar per ngritjen e strukturave te tilla (organizata rinore, grupe te rinjsh, individe, etj)</p> <p>8.A keni patur ju forma të tjera bashkëpunimi me grupe të rinjsh ,organizat rinore etj për zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinnë?</p> <p>9. Sa eshte me perafersi pjesemarrja e te rinjve ne konsultimet publike te zhvilluara</p>	19.07.2023	<p>1.Ju arsyetojmë se në Bashkinë Mallakastër ka të planifikuar një buxhet me vlerë prej 1.000.000 lekë, vlerë e llogaritur në përqindje është e papërfillshme pasi në territorin e Bashkisë sonë nuk ka OJF që mund të praqesin projekte dhe ti realizojmë ato në bashkëpunim</p> <p>2.Bashkia Mallakastër i ka dhënë prioritet punësimit të të rinjëve sipas kualifikimeve të gjithësecilit. Janë të punësuar individë të moshës 18-29 vjeç rreth 10 të tillë ( 7 femra 3 meshkuj).</p> <p>3.E llogaritur në përqindje zë afërsisht 0.9 % të numrit të përgjithshëm të punonjësve.</p> <p>4,5. Në institucionin tonë ka struktura përgjegjëse për Rininë pasi është ngritur Këshilli vendor Rinor i cili drejtohet nga Titullari i Bashkisë dhe anëtar nga përfaqësues të Rinisë të moshës 15-29 vjeç. Ka kordinator për Rininë i cili kordinon dhe bashkërendon punën për funksionimin e këtij Këshilli.Janë bërë seanca këshillimore për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit vendor rinor me grupe të rinjesh , individë të tjerë, nxënës të shkollave të mesme dhe studentë.</p> <p>6.Nuk kemi zyra ose qendër për rininë por nëse do të ketë projekte Bashkia Mallakastër do të marr përsipër pjesën takuese të financimit për ndërtimin dhe funksionimin e një qendre rinore</p> <p>7.Për ngritjen e strukturave rinore kemi bashkëpunuar me organizatën “ Qendra Rinore Epoka e re” të cilët na kanë ndihmuar për mbarëvajtjen e këtij procesi. Kemi bashkëpunuar me organizatën “Lëviz Albania “ për projekte me rininë si dhe me qendrën rinore “Albion” për organizimin me të rinj në kampe verore</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagessë

		nga bashkia? Cilat jane disa nga mjetet apo mekanizmat qe perdor bashkia ne perfshirjen e te rinjve ne te tilla procese		8.Për sa i përket pjesëmarrjes së të rinjëve në konsultimet publike, nga ana e Bashkisë janë miratuar politika mbështetëse për të rinjtë kryesisht të moshës 14-18 vjeç, nxënës ekselent të cilët shpërblehen me bursë prej 5000 lekë në muaj si dhe për fituesit e olimpiadave ka shpërblime të tjera të caktuar me vendim të këshillit bashkiak, fond ky nga te ardhurat e veta Për deri sa ka politika mbështetëse për të rinjtë dhe interesi i tyre për pjesëmarrje në konsultime ka ardhur duke u rritur.		
06	11.08.2023	<p>1.Sa eshte numri i Kopshteve dhe Çerdheve në bashkinë Mallakastër?</p> <p>2.Sa nga këto kopshte dhe Çerdhe janë me ushqim?</p> <p>3.Sa është numri i fëmijëve përfitues nga ushqimi në Çerdhe gjatë vitit?</p> <p>4.Sa është kosto e ushqimit për Çerdhet në një vit?</p> <p>5.A paguajnë prindërit e fëmijëve tarifë ditore për ushqimin e fëmijëve?</p> <p>6.A ka konvikt në bashkinë tuaj?</p> <p>7.Sa është numëri i nxënësve në konviktin bashkiak?</p> <p>8.Sa është tarifa vjetore e qirasë që paguajnë nxënësit?</p> <p>9.A ofron ushqim konvikti për nxënësit?</p> <p>10.Sa është kostoja vjetore e ushqimit për nxënësit?</p>	21.08.2023	<p>1.Në bashkinë Mallakastër janë 31 kopshte dhe 1 çerdhe.</p> <p>2. Një kopsht dhe një çerdhe është me ushqim .</p> <p>3. 37 fëmijë përfitues nga ushqimi në çerdhe.</p> <p>4.Kosto e ushqimit për çerdhet në një vit është 766,466.41</p> <p>5.Prindërit e fëmijëve paguajnë tarifë ditore për ushqimin.</p> <p>6. Nuk ka konvikt në bashkinë tonë.</p> <p>7. Nuk kemi konvikt bashkiak.</p> <p>8. Nuk ka tarifë qiraje.</p> <p>9.Nuk ka konvikt.</p> <p>10.Nuk ka kosto ,pasi nuk ka konvikt.</p>	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë

<b>07</b>	<b>01.09.2023</b>	Ju lutem na dërgoni emrat e ish kryetarëve të bashkisë suaj nga viti 1992 deri aktual si dhe kryetarët e komunave nga viti 1992 deri 2015 si dhe listat e personave që janë komanduar në njësitet administrative.	<b>07.09.2023</b>	Është dhënë informacioni përkatës për të gjithë kryetarët e bashkisë nga 1992 deri te kryetari që është aktualisht. Janë dhënë gjithashtu emrat e kryetarëve të të gjithë komunave nga viti 1992-2015. Janë dhënë dhe listat e personave që janë komanduar në njësitet administrative.	Përfunduar elektronikisht	Pa pagesë
-----------	-------------------	---	-------------------	--	---------------------------	-----------